

**Një dyshim, një pyetje ?
CLAT* ju përgjigjet**

***Qendra e Luftës**

Kundër Tuberkulozit


Tuberkulozi

**Informacione që i drejtohen
personave të sëmurë**

SËMUNDJA E TUBERKULOZIT

Eshtë një sëmundje infektuese për shkak të një mikrobi : bacille de Koch ose BK.

Ajo prek sidomos mushkëritë por gjithashtu dhe organe të tjera. Kjo sëmundje kurohet me antibiotikë.



SHENJAT



Kollë



Pështymë me gjak



Djersitje nate



Humbje peshe



Lodhje



Temperaturë

Vërejtje : Ju mund të keni tuberkulozin dhe të shprehni vetëm njëri nga këto simptoma apo të keni simptoma të tjera dhe kjo varet nga vendi që është prekur nga sëmundja.

Bacille de koch (BK) është një bakteri, e cila luftohet me antibiotikë. Mjekimi është i gjatë : minimumi gjashtë muaj. Në fillim, ju do të pini tre ose katër ilaçe, më pas mjekimi do të jetë më i lehtë pas disa muajsh.

Marrja e mjekimit :


Mjekimi është efikas vetëm nëse merret:

- Çdo ditë, **pa ndërprerje** ;
- esëll ;

Të mos e ndaloni dhe as ta ulni mjekimin pa marrë një mendim mjekësor edhe nëse shfaqen efekte anësore.

Në rast se ju e ndaloni mjekimin apo nëse nuk e merrni ashtu siç duhet, tuberkulozi **mund të mos shërohet** dhe sidomos bakterija bacille mund të bëhet **rezistuese** ndaj ilaçeve të zakonshme të cilët humbasin efikasitetin e tyre.

Duhet në këtë rast të merrni mjekime më të gjata dhe më të komplikuara.



1. Pini ilaçet në mëngjes, esëll
2. Prisni 30 minuta para se të hani



3. Vakte normale



4. Prija e alkolit është e rrezikshme




5. Mos hani asgjë gjatë natës


Efektet dytësore kryesore të mjekimit :

- ngjyrë portokalli të lotëve dhe të urinës ;
- heqja e efikasitetit të pilulës kontraceptive ;
- rrezik çrregullimi i testeve të hepatitit ;
- rrezik të keni shqetësime me shikimin ;
- çrregulime të tretjes në fillim të marrjes së mjekimit ;
- ndonjëherë skuqje dhe tesha në lëkurë.


Nëse këto efekte shtohen, luteni të kontaktoni CLAT.



Urinë me ngjyrë portokali



Lotë me ngjyrë portokalli



Pilula nuk ju mbron më

NDJEKJA MJEKËSORE DHE SOCIALE

Ndjekja mjekësore :

- konsultë mjekësore çdo mujore ;
- analizë gjaku ;
- konsultë te doktori i syve.

Ndjekja nga ana radiologjike lejon të kontrollohet efikasiteti i mjekimit.



Të vini përsëri në konsultë

Të bëni një analizë gjaku
në laborator
për të parë gjendjen e mëlçisë



Ndjekja nga ana sociale :

Tuberkulozi është një sëmundje që zgjat. (ALD).

Mjeku plotëson një kërkesë për marrjen tuaj përsipër 100%, në mënyrë që mjekimet të jenë falas, si dhe ekzaminimet dhe mjekimi që përdoret për këtë sëmundje.

Nëse ju nuk keni sigurim social, ju mund të takoni një asistent(e) social(e) në mënyrë që t'ju ndihmojë në lidhje me situatën tuaj.

Qendra për Luftën Kundër-Tuberkulozit (CLAT) siguron ndjekjen tuaj mjekësore dhe jep falas ilaçe kundër tuberkulozit për personat të cilët nuk kanë sigurim social.

PËRHAPJA E SËMUNDJES

Tuberkulozi transmetohet sidomos nëpërmjet ajrit ; kontakti fizik dhe ndarja e sendeve të ndryshme të jetës së përditshme është pa rrezik.

Prandaj, pjesa më e madhe e njerëzve të sëmurë shtrohen në spital deri sa të mbarojë perioda e ngjitjes. Ata që nuk shtrohen, duhet, për të mbrojtur të afërmit e tyre, të mbajnë një **maskë** (gjatë 3 javëve deri në një muaj pas fillimit të mjekimit) dhe **të ajrosin dhomat rregullisht** vetëm nëse janë prekur nga rrugë jashtë-mushkërive, e cila është «jo ngjitëse».

Para mjekimit, vlerësohet se **ngjitja** e sëmundjes ka filluar mesatarisht 3 muaj para diagnozës.

Prandaj një **kërkim** realizohet nga **CLAT** me aprovimin dhe me ndihmën tuaj. Ai lejon të gjenden personat të cilët kanë qenë në kontakt me ju dhe të bëhet testimi i tyre. Një infermiere e **CLAT** do ju ndihmojë në këtë përçapje.

Personat për tu testuar seleksionohen sipas kriterëve :

- **kohëzgjatja** dhe **afërsia** e kontaktit me personin e sëmurë,
- **izolimi** i dhomës ku kanë ndodhur kontaktet.

Informacionet e mbledhura mbrohen nga sekretet profesional.

Lufta kundër tuberkulozit është një masë që merret për mbrojtjen e shëndetit publik, testimi në **CLAT** është falas për të gjithë.



Kollitje dhe teshtima



Fjala (çiklat e pështymës)



Të ajrosen dhomat



Të mbahet një maskë

NJË DYSHIM, NJË PYETJE,

- Nga cili mjek do të ndiqem ?
- Sa kohë do të zgjasë mjekimi ? Në çfarë kohe duhet ta marr ?
- Çfarë duhet të bëj në rast efektesh dytësore ?
- Nuk kam më ilaçe dhe nuk do ta takoj doktorin para një jave, çfarë duhet të bëj?
- Kam harruar të marr mjekimin një ditë.
- Ku bëhen ekzaminimet për kontrollet (radiologji, analizë gjaku...) ?
- Nuk kam sigurim social : duhet ti paguaj vetë ilaçet dhe ekzaminimet?
- Çfarë duhet të bëj nëse më vjen një faturë nga spitali ?
- Pas sa kohësh mund të dal nga shtëpia ?
- A do ta marrin vesh të gjithë që kam tuberkulozin ?
- Të afërmit e mi kanë frikë : duhet të rri mbyllur brenda ?
- Kush mund të testojë të afërmit e mi ?
- Testimi i të afërmeve të mi është me pagesë ?
- Dhe për punën time ?

Për të marrë një përgjigje për të gjitha këto pyetje si dhe të tjera, kontaktoni CLAT

SHËNIME PERSONALE

A series of horizontal dotted lines for writing notes.

Si të lidheni me CLAT ?

Në spitalin Arnaud de Villeneuve, Pavioni i Pneumologjisë.



Ekipi i CLAT :

Dr J. CHARRIOT, pneumolog dhe përgjegjës i pavionit

Dr C. COVAS

Dr S DUTRON

Ekipi i infermierëve ; Elodie BOUSQUET, Hélène BRUGIERE dhe Stéphanie JUSTET

Koordinatorë : Adeline SAGNAT


Sekretare : Sylviane BOULOUYS

Telefon 04 67 33 60 84

Faks 04 67 33 22 75

Email clat@chu-montpellier.fr

Konsulta mjekësore me TAKIM të martën dhe të enjten



Dokument i realizuar nga V. ANDRIEU, I. BARTHES dhe L. CAUMETTE (vizitime nga F. LAUTRAM) – Përditësimi : janar 2017.

Konceptimi : Zyra e Komunikimit, CHU i Montpellier, (01/21), G. FAUGIER